



BACHELOR

TEKNOLOGJI INFORMACIONI NË BUJQËSI DHE MJEDIS

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Programi Bachelor “Teknologji Informacioni në Bujqësi dhe Mjedis”, në bashkëpunim me **Universitetin BOKU**, u përgjigjet nevojave të transformimit digjital të bujqësisë shqiptare dhe kërkesave të integritetit në BE.

Programi përgatit specialistë që përdorin programimin, IoT, GIS dhe analizën e të dhënave për të përmirësuar prodhimin bujqësor dhe monitorimin mjedisor.


Studentët mësojnë si të rrisin produktivitetin, të kursejnë burimet natyrore dhe të ulin ndikimin klimatik, duke kontribuar në zhvillimin e një bujqësie më të zgjuar dhe një mjedisi më të pastër, në përputhje me standardet dhe praktikatat bashkëkohore europiane.



Përshkrimi i programit

Programi është ndërdisiplinor dhe praktik, duke kombinuar bazat e informatikës (programim, databaza, rrjete), shkencën e të dhënave dhe teknologjitë gjeohapësinore me agronominë, agrometeorologjinë dhe menaxhimin mjedisor. Studentët mësojnë të projektojnë dhe operojnë sisteme të bujqësisë precize (sensorë, IoT, GPS, dronë), platforma monitorimi dhe vendimmarrjeje, si dhe aplikime për shërbime digjitale publike në bujqësi. Programi mbështetet në laboratorë, punë në terren dhe projekte me ferma dhe agrobiznese.

**Diplomë që njihet
ndërkombëtarisht**



Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit janë specialistë të aftë të analizojnë, projektojnë dhe zbatojnë zgjidhje IT për bujqësinë dhe mjedisin, duke përdorur programim (Python/R), databaza dhe cloud, GIS/Remote Sensing dhe pajisje IoT për monitorimin dhe optimizimin e resurseve. Ata punojnë në ekipe ndërdisiplinare, respektojnë standardet e sigurisë së të dhënave dhe raportojnë qartë për palët e interesuara.

Profile të mundshme të diplomuarish:

- **Specialist i bujqësisë precize** dhe automatizimit të fermës
- **Analist i të dhënave agro-mjedisore** (GIS & Remote Sensing)
- **Inxhinier/Integrator IoT** për sensorizim dhe monitorim mjedisor
- **Specialist IT** për sisteme publike digjitale në bujqësi (regjistra, IACS, etj.)



Xhulio Gjeka

Administrator "Alba Agro"

"Programi IT në Bujqësi dhe Mjedis mbështet modernizimin dhe automatizimin e prodhimit të fidanëve, duke lidhur teknologjinë me praktikën, standardizuar proceset, monitoruar mikroklimën, më pak humbje dhe besueshmëri më të madhe nga klientët."



Redion Karriqi

Solution Sales Manager në
Vodafone Smart Agro

"Bujqësia digjitale është më shumë se teknologji; është një qasje e re në vendimmarrje që kursen burime dhe rrit rendimentin, ku zgjidhjet Smart Agriculture të Vodafone sjellin transparencë, efikasitet dhe vlerë të qëndrueshme për fermerët dhe bizneset bujqësore."



Arbi Bamllari

CEO, SKAITECH

"Digjitalizimi i bujqësisë nuk është thjesht e ardhmja, është domosdoshmëri. Dronët po e ngrehnë bujqësinë në një dimension të ri; më të saktë, më inteligjente dhe më efikase. Te SKAITECH besojmë se inovacioni fluturon mbi fushat dhe kulturat tona."



Bianca Duro

CEO "Austria Praemix"

"Blegtoria po modernizohet përmes automatizimit, digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale, duke përmirësuar menaxhimin e fermave dhe cilësinë e produkteve, ndërsa Austria Praemix po aplikon në Shqipëri paketën Smaxtec për transformimin e proceseve në fermat e gjedhit."

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- **Menaxhim** i të dhënave bujqësore: mbledhje, ruajtje, databaza dhe vizualizim.
- **Bujqësi precize & IoT**: sensorizim, GPS, dronë, telemetri dhe optimizim i inputeve.
- **GIS/Remote Sensing**: analiza hapësinore, hartëzim dhe monitorim i tokës, ujit e klimës.
- **Automatizim & vendimmarrje**: modele, dashboards, alarme dhe siguri e të dhënave.

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Bazat e matematikës/fizikës, Agronomisë dhe informatikës (programim, algoritme).

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Databaza, Rrjete, GIS, Sensorë/IoT, Agrometeorologji dhe analiza e të dhënave.

TË TJERA

Bujqësi precize, Automatizim, Aplikime mjedisore, Praktikë profesionale dhe punim diplome

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

Mundësi Punësimi:

- Specialist bujqësie precize / menaxhim fermash
- Analist GIS dhe monitorim mjedisor
- Integrator IoT dhe automatizim
- Zhvillues aplikacionesh / administrator sistemesh
- Sipërmarrës në shërbime digjitalizimi

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në Teknologji Informacioni në Bujqësi dhe Mjedis

Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

Kredite

180 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

100 studentë

Përfundimi i studimeve


Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Pas përfundimit të ciklit Bachelor, studentët mund të vazhdojnë studimet Master në UBT ose universitete të tjera në fusha si Shkenca e të Dhënave, GIS/Remote Sensing, Automatizim dhe Mekatronikë, Inxhinieri Mjedisë, si dhe programe të specializuara në Bujqësi Digjitale dhe Menaxhim Burimesh. Programi ofron një bazë të fortë për studime të mëtejshme dhe mundësi për mobilitete Erasmus+.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



[universiteti_bujqesor_tiranes](https://www.instagram.com/universiteti_bujqesor_tiranes)
[fbm_ubt](https://www.instagram.com/fbm_ubt)



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit- Faqja Zyrtare

Për jetën dhe të ardhmen...